

**Akt Themelimi
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
“JDS”**

Joni Dýrmishi, i biri i Misir, lindur në Çorovodë, Skrapar me datë 26.05.1994, banues në Çorovodë, Lagjia “Çlirim”, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identikuar nga karta e identitetit nr. 029976025,

si themelues i vetëm i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendos të hartoj këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

Neni 1

Sot, më datë 07.03.2013, themeluesi i vetëm krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të quajtur “**JDS**”. Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar për aq kohë sa nuk do të merret një vendim për shndërrimin e saj në një formë tjeter shoqërie të parashikuar nga legislacioni për shoqërítë tregtarë.

Neni 2
Emri

Emri i plotë i shoqërisë është “**JDS**” sh.p.k.

Neni 3
Zyra Qendrore

Selia qendrore e shoqërisë do të jete në adresën: Lagjia “Çlirim”, banesë private, Çorovodë, Skrapar, Shqipëri.

Neni 4
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

Neni 5
Objekti i Veprimtarisë

Shoqeria “**JDS**” Sh.p.k ka për objekt të veprimtarisë:

- Studim, projektim e ndërtim të ndërtesave publike, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nënkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, reabilitimin e veprave ujitëse, ujësjellësave, linjave mbitokësore e nëntokësore për energjinë dhe telekomunikacionet, centraleve dhe hidrocentraleve,

objekteve turistike dhe të kultit, rrjetete inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, realizimin e studimeve urbane, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksionet e veprave të artit, montimet e prodhimet e konstruksioneve metalike dhe beton armeje, plastikë të drurit dhe kombinime të ndryshme të tyre, prodhim konstruksione të dyerve, dritareve dhe montimeve të veshjeve me duroalumin, prodhimin e materialeve te ndertimit, inerteve dhe asfaltobetonit, studime, projektime, mbikqyrje dhe menaxhim në fushën e metalurgjisë dhe mbrojtjes së mjedisit, shkrirje, derdhje dhe perpunim plastik (në të nxeh të dhe në të ftohtë), të metaleve ferroze dhe joferroze, trajtimin e mbetjeve teknologjike, industriale, tokiske dhe radioaktive, trajtimin e ujërave industriale, prodhimin e bojrate dhe llakeve të ndryshme, të ambalazheve, cdo operacion industrial prodhues, prodhimin e vajrave të ndryshëm ushqimor dhe joushqimor, prodhimin e sapunëve, studime, projektime mbikqyrje në fushën e kërkimit dhe shfrytëzimit të lëndës drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftesimin dhe trajtimin e tokave të kripura, të kënetave si dhe cdo veprimtari që ka rëndësi për shoqërinë.

- Tregëtim dhe import-eksportin e mallrave të ndryshme industriale, ushqimore, mjekësore, të materialeve të ndërtimit, aparaturave, të mediave, të import-eksportit të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të pajisjeve e makinerive të ndryshme, të materialeve ferroze dhe joferroze, të lendës drusore, të lendeve të para kimike, biokimike, të përpunuara dhe gjysëm të përpunuara për procesin e prodhimit, tregëtimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, shitblerjen e tokës, tregëtimin e mallrave të gatshëm e gjysëm të gatshëm.
- Kerkim, nxjerrje, përpunim, tregetim, import, eksport te mermerit, pllakave, materialeve inerte dhe cdo veprimtari tjeter tregetare qe lidhet me burimet e resurseve natyrore.
- Kryerja e çdo operacioni ekonomik dhe juridik, industrial, prodhues, tregëtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e veprimtarisë së shoqërisë. Brënda kuadrit të dispozitave ligjore, shoqëria do të kryejë çdo biznes të përshtatshëm për arritjen e qëllimit të saj.

Neni 6

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë eshte 100 (njëqind) Lekë.
Ky kapital është i ndarë në 100 (njëqind) kuota.
Secila prej kuotave ka vlerë nominale 1 (një) Lekë.

**Neni 7
Administratori**

Administrator i parë i shoqërisë do të jetë **Z. Joni Dyrmishi**.
Administratori i pare i shoqërisë do te qendroje në detyrë për një afat 3 vjeçar.

**Neni 8
Dispozita e fundit**

Ky akt themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.

THEMELUESI I VETEM

Joni DYRMISHI

Joni Dyrmishi

Datë 07/03/2013

